

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË
DEPARTAMENTI: AGROEKONOMI
PROGRAMI: EKONOMIA E BUJQËSISË DHE USHQIMIT



PUNIMI I DIPLOMËS MASTER

Tema me titull:

Analiza e preferencave të konsumatorëve për djathin në rajonin e Vushtrrisë

Udhëheqësi shkencor:

Prof. Ass. Dr. Njazi Bytyqi

Kandidatja:

Bsc. Njomza Mehmeti

Prishtinë, Janar, 2022

Abstrakti

Preferenca e konsumatorit përkufizohet si një grup supozimesh që fokusohen në zgjedhjet e konsumatorëve që rezultojnë në alternativa të ndryshme si lumturia, kënaqësia ose dobia. Për shkak se preferenca e konsumatorit përcakton se cilat produkte do të blejnë njerëzit brenda buxhetit të tyre, na lë të kuptojmë që ka rëndësi shumë të madhe në treg si në vendet e zhvilluara ashtu edhe në vendin tonë. Duke marrë parasysh që djathi është një ndër produktet më të pëlqyera dhe më të konsumuara në vendin tonë, prandaj edhe objektivi i këtij studimi ishte të analizohej preferenca e konsumatorëve rreth këtij produkti.

Hulumtimi u zhvillua në komunën e Vushtrrisë, përkatësisht në vendet e furnizimit si supermarkete, dyqane dhe tregje. Mostra e përzgjedhjes së pjesëmarrësve ishte e rastësishme, ku përmes intervistës me anë të pyetësorëve u grumbulluan të dhënat e këtij punimi. Madhësia e mostrës përbëhej prej 100 intervistave me konsumatorë të djathit. Këto të dhëna më pastaj janë regjistruar dhe përpunuar dhe analizuar përmes programeve Excel dhe SPSS.

Rezultatet e studimit tregojnë se tek konsumatorët e intervistuar, shija dhe cilësia e djathit ndikojnë më së shumti në përzgjedhjen e djathit, ndërsa çmimi ishte mesatarisht i rëndësishëm në preferencën dhe përzgjedhjen e djathit. Shumica e konsumatorëve besonin më shumë në djathin vendor sesa në atë të importuar e kjo si arsye e cilësisë dhe sigurisë së djathit. Për nga shkalla e rëndësisë faktori më i rëndësishëm doli të ishte data e skadimit për pothuajse të gjithë konsumatorët, ndërsa faktorët më pak të rëndësishëm ishin ambalazhi, reklama dhe reputacioni i markës.

Lloji i djathit më i parapëlqyer doli të jetë “djathi mesatarisht i fortë” si dhe djathi i llojit “të butë” me një diferencë shumë të vogël sesa ai paraprak. “Djathi i bardhë” dhe “Djathi Feta” ishin llojet më të preferuara të konsumatorëve Vushtrrias.

Fjalët kyçe: Preferencat e konsumatorëve, djathi, Vushtrri, konsumi